



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 725 / prot.  
3

Tiranë më 27.07.2020

VENDIM

Nr. 32, datë 27.07.2020

PËR KONTROLLUESIN “VALIDATA SOFTWARE ALBANIA” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Validata Software Albania” SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 109, datë 16.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye një hetim administrativ pranë kontrolluesit “Validata Software Albania” SHPK (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi “Validata Software Albania” SHPK.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë e tij në fushën e programimit/kodimit, testimit dhe mirëmbajtjes së aplikacioneve/software.

Në kuadër të marrëdhënies së punës, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale “kandidatë për punë”, dhe “punëmarrës”.

Kontrolluesi, gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave për kategoritë e subjekteve të të dhënave "kandidatë për punë", nuk informon këto subjekte mbi të drejtat e tyre sipas parashikimeve në nenin 18 të Ligjit, për mënyrën e përpunimit të të dhënave, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim dhe/ose fshirje të të dhënave të tij, si dhe të drejtën e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson atyre të njihen me të drejtat që iu janë akorduar me Ligj, si dhe iu mundëson, gjithashtu, ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

2. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Pika 1 e nenit 21 të Ligjit parashikon se njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë.

Kontrolluesi, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e tij që prej datës 14.09.2017.

Më tej, pika 1 e nenit 25 të Ligjit parashikon se kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit.

Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

3. Gjatë hetimit administrativ, Kontrolluesi deklaroi se ka marrëveshje bashkëpunimi me palë të treta në cilësinë e përpunuesit, por nuk i vendosi në dispozicion të grupit të hetimit administrativ me pretendimin se këto marrëveshje ndodhen pranë zyrës ligjore.



Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi, për përpunimin e të dhënave personale, mund të angazhojë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Detyrimet e përpunuesit duhet të jenë të përcaktuara qartë në një kontratë të shkruar midis kontrolluesit dhe përpunuesit, në zbatim të nenit 20 të Ligjit, si dhe në përputhje me Udhëzimin nr.19, datë 03.08.2012, të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, nuk ka kundërshtuar shkeljet e konstatuara, por ka paraqitur si prova për të dokumentuar rikuperimin e tyre, si më poshtë vijon:

- (i) Formularin e njoftimit;
- (ii) Dokumentin “*Validata Group – Information Security Policy*” (në gjuhën angleze);
- (iii) Dokumentin “*Agreement between Validata Holdings Limited - Validata Software Albania SHPK*” (në gjuhën angleze).

Lidhur me provat e paraqitura nga Kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, konstatojmë se Kontrolluesi ka dokumentuar rikuperimin e një prej shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij (detyrimin për njoftim).

Lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit, me palët e treta në cilësinë e përpunuesit (dokumentet e treguara në pikat (ii) dhe (iii) këtu më sipër, konstatojmë se, këto marrëveshje janë në gjuhë të huaj.

Bazuar në pikën 1 të nenit 20 të Kodit të Procedurave Administrative, e cila përcakton se “*Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, procedura administrative kryhet në gjuhën dhe shkrimin shqip*”, i gjithë dokumentacioni duhet paraqitur në gjuhën shqipe.

Ndonëse Zyra e Komisionerit vlerëson reflektimin e Kontrolluesit, kjo nuk e përjashton atë nga përgjegjësia administrative pasi shkeljet e konstatuara janë kryer para daljes së urdhrit të hetimit administrativ.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ përbëjnë kundërvajtje administrative, në kuptim germave “b”, “ç”, dhe “d” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, si dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- b) *Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë”;*
- ç) *Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë”;*
- d) *Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2, të nenit 39, të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 18, 20, 21, 29, 30, 39 (pika 1, germat “b”, “ç” dhe “d”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen në vijim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, etj.;
4. Kontrolluesi, të vërë në dispozicion të Komisionerit versionet e përkthyer rregullisht në gjuhën shqipe të kontratave/marrëveshjeve të përpunimit, në të cilat të përfshihen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me parashikimet në nenin 20 të Ligjit si dhe Udhëzimin nr.19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;



6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit, të përmbushen detyrimet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 më sipër, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni të këtij akti, si dhe të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
7. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
8. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më 22.07.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

